



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 666/4 Prot.

Tiranë, më 22.09.2021

V E N D I M

Nr.113, datë 22.09.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt verifikimin e ligjshmërisë së urdhrit nr. 95, datë 21.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësen *** dhe akteve të transferimit të përkohshëm duke përcaktuar edhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 666 prot., datë 14.06.2021, kërkuësja ***** ka parashtruar pretendimin se ndaj saj është marrë në mënyrë të padrejtë dhe në zbatim të gabuar të legjislacionit material, masa disiplinore “Vërejtje”.

Duke marrë indicje nga kjo kërkesë, bazuar në nenin 16, Kreut III, “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u administrua gjithë dokumentacioni shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunëses,

dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. 1688/4 prot., datë 09.07.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “*Kthim përgjigje*”, si dhe dokumentacioni i administruar nëpërmjet komunikimit elektronik nga subjektet përkatëse.

Në përfundim të shqyrtimit të materialeve të mësipërme në kuadër të hetimit administrativ, rezulton se: Në zbatim të pikës 4, të vendimit nr. 8, datë 15.02.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Tropojë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, me aktin nr. 3215/1, datë 18.08.2019, ka deklaruar statusin e punësimit për nëpunësen *****, si “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike*”, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë.

Me urdhrin nr. 97, datë 17.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “*Për komandimin e nëpunëses civile ******”, rezulton se për nevoja të institucionit, nëpunësja ***** është komanduar (transferuar) në pozicionin “*Specialist i Ndihmës Ekonomike, paaftësisë dhe invaliditetit*”, në Njësinë Administrative Fierzë, duke mos ndryshuar kategoria e pagës. Në përmbajtje të këtij akti, konstatohet se caktimi në këtë detyrë është pa afat, duke filluar prej datës 23.04.2020 deri në një urdhër të dytë.

Ndërkohë, në zbatim të kompetencave të tij, Kryetari i Bashkisë Tropojë (*akte të cilat nuk janë vënë në dispozicion*), ndër të tjera, në dy raste ka urdhëruar edhe verifikimin e prezencës në punë të punonjësve të Njesisë Administrative Fierzë, konkretisht:

- Në datën 05.05.2021, nëpërmjet grupit të punës, përbërë nga punonjësit ***** dhe ***** është verifikuar prezenca e punonjësve në punë, për orën 08:15, në përfundim të të cilit është mbajtur akt-konstatimi nr. 1449 prot., datë 05.05.2021;
- Në datën 11.05.2021, një grup tjetër pune i përbërë nga punonjësit ***** dhe ***** ka verifikuar prezencën në punë të punonjësve të njesisë, në orën 15:20, në përfundim të të cilit është mbajtur akt-konstatimi nr. 1592 prot., datë 11.05.2021.

Nga përmbajtja e akteve të mësipërme të konstatimit, është evidentuar fakti se, nëpunësja ***** nuk ka qenë prezente në punë në momentin e kryerjes së verifikimit. Pas njohjes me konstatimet e paraqitura nga grupi i punës, Kryetari i Bashkisë Tropojë me urdhrin nr. 79, datë 07.05.2021 dhe urdhrin nr. 84, datë 12.05.2021, ka vendosur heqjen e ditës së punës për nëpunësen në fjalë.

Nga dokumentacioni i administruar nëpërmjet komunikimit elektronik, konkretisht librit të hyrje-dalje, rezulton se, aktet për heqjen e ditës së punës janë protokolluar pranë Njesisë

Administrative Fierzë, respektivisht në datën 17.05.2021 dhe datën 19.07.2021, por nga ana tjetër, nuk evidentohet fakti se kur nëpunësja ***** ka ardhur në dijëni të heqjes së ditës së punës, pasi nga institucioni nuk janë vënë në dispozicion këto akte.

Përveç veprimeve të mësipërme administrative, për të njëjtin shkak, rezulton se Kryetari i Bashkisë Tropojë, me urdhrin nr. 95, datë 21.05.2021, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për nëpunësen *****. Në përmbajtje të këtij akti, parashtrohet se, masa disiplinore ndaj kësaj nëpunëseje është marrë për shkak të mungesës së pajustificuar në punë dhe për thyerje të rregullave të etikës, të cilat në kuptim të nenit 57, pika 4, germa “a” dhe “b”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, klasifikohen si shkelje të lehta.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë këtij procesi, rezulton se nëpunësja ***** nuk ka pasur dijëni për zhvillimin e një ecurie disiplinore në ngarkim të saj, deri në momentin, kur në datën 07.06.2021, është vënë në dijëni të vendimit nr. 95, datë 21.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, fakt që materializohet nëpërmjet nënshkrimit të saj në librin e dorëzimit të objekteve të regjistruara. Në kushtet e mospasjes dijëni për fillimin e ecurisë disiplinore, nëpunësja ***** nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 1000/1 prot., datë 09.06.2021, ka kërkuar të drejtën për t’u njohur me dokumentacionin e plotë të dosjes, për të cilën rezulton të mos ketë marrë asnjë përgjigje.

Nisur nga sa më sipër, në vlerësim të rrethanave dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se, në zhvillimin e procedurës për marrjen e masës disiplinore ndaj nëpunëses ***** janë kryer/lejuar shkelje të elementëve proceduralë, të përcaktuar në Kreun X të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Në përmbajtje të dispozitave që rregullojnë institutin e disiplinës, përcaktohet procedura që duhet ndjekur, e cila nënkupton të gjithë veprimtarinë administrative që kryhet që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore, vënies në dijëni me shkrim të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi disiplinor, nga personat kompetentë për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga dokumentacioni i administruar, konstatohet se masa disiplinore për punonjësen ***** është vendosur me motivacionin e shkeljes së rregullave të etikës si dhe mungesës së pajustificuar, shkelje të cilat, në vështrim të nenit 57, pika 4, germa “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, klasifikohen si shkelje të lehta. Në kuptim të nenit 58, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, organi kompetent për shqyrtimin e shkeljeve të lehta disiplinore është eprori direkt, i cili me marrjen dijëni të shkeljeve disiplinore mund të fillojë menjëherë ecurinë disiplinore.

Në lidhje me rastin konkret, Komisioneri konstaton se nuk janë respektuar disa nga dispozitat ligjore në të cilat përcaktohen elementët proceduralë të ecurisë disiplinore, të cilat parashtrihen në vijim:

Së pari, nuk janë respektuar dispozitat në lidhje me vënien dijani të nëpunësit civil për fillimin e procedimit disiplinor dhe ecurinë e këtij procesi. Në kreun II, pika 13, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, përcaktohet se, në rastin e marrjes dijani për një shkelje disiplinore, organi disiplinor (eprori direkt) fillon ecurinë disiplinore dhe njofton me shkrim, nëpunësin të cilit i atribuohet shkelja:

- a) për shkeljen disiplinore të pretenduar se është kryer;
- b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
- c) për të drejtën që ka ai për të inspektuar dosjen e procedimit, për t’u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;
- d) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar.

Duke ju referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, në lidhje me aspektin që po trajtojmë, konstatohet se Kryetari i Bashkisë Tropojë, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në kuadër të njoftimit të nëpunëses *****, për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të saj. Njëkohësisht nuk evidentohet ndonjë akt administrativ, nëpërmjet të cilit të materializohen veprimet e kryera nga organi disiplinor, eprori direkt, në kuadër të shqyrtimit të shkeljeve të pretenduara.

Nisur nga sa më sipër, në mungesë të akteve të nevojshme që materializojnë njoftimin e nëpunësit si dhe veprimet e organit disiplinor, në kuadër të shqyrtimit të shkeljeve, Komisioneri arrin në konkluzionin se, në rastin konkret janë lejuar shkelje të elementëve proceduralë, duke cënuar jo vetëm ligjshmërinë e këtij procesi, por edhe të drejtat legjitime të nëpunëses ***** për t’u njoftuar lidhur me fillimin e ecurisë disiplinore dhe me shkeljet që i atribuohen, si dhe të drejtën për të paraqitur me shkrim pretendimet dhe provat rreth shkeljes.

Së dyti, rezulton se, Kryetari i Bashkisë Tropojë ka vendosur dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*”, duke mos kryer një hetim të plotë administrativ dhe të gjithanshëm, sipas kërkesave të Kodit të Procedurave Administrative.

Nga përmbajtja e urdhrin nr. 95, datë 21.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “*Për dhënien mase disiplinore*”, konstatohet se ndaj nëpunëses ***** , është vendosur

marrja e masës disiplinore “Vërejtje”, për shkak të mungesës së pajustificuar në punë, si dhe për shkak të thyerjes së rregullave të etikës. Por, nga ana tjetër, në përmbajtje të këtij akti nuk evidentohen qartësisht, se cilat kanë qenë këto rrethana dhe fakte të cilat kanë shërbyer për marrjen e kësaj mase disiplinore.

Në lidhje me motivacionin e mungesës së pajustificuar në punë, vendimi është bazuar në akt-konstatimet e mbajtura nga grupi i punës, i caktuar me detyrën e kryerjes së verifikimit të prezencës në punë të punonjësve të Njesisë Administrative Fierzë. Konkretisht, rezulton se, grupi i punës, gjatë verifikimit të kryer në datën 05.05.2021, në orën 08:15, ka konstatuar mosprezencën në punë të nëpunëses *****, fakt i cili është pasqyruar në akt-konstatimin me nr. 1449 prot., datë 05.09.2021. Po kështu, mosprezenca në punë e nëpunëses në fjalë është konstatuar edhe gjatë verifikimit të kryer në datën 11.05.2021, ora 15:20, për të cilin është mbajtur procesverbali me nr. 1592 prot., datë 11.05.2021.

Nga përmbajtja e akteve të mësipërme të konstatimit, rezulton se grupi i punës ka evidentuar vetëm mosprezencën në punë, për orarin e kryerjes së këtij verifikimi, por nuk ka parashtruar nëse kjo mosprezencë ka ardhur si rrjedhojë e braktisjes së punës prej nëpunëses *****, apo si pasojë e ndonjë shkakut tjetër të justifikuar. Për më tepër, në praktikën shkrese të dërguar nga institucioni, rezulton se këto akt-konstatime nuk i janë njoftuar nëpunëses në kohë, duke i hequr në këtë mënyrë mundësinë për të paraqitur argumentet e nevojshme ligjore apo faktike për mosprezencën e konstatuar.

Në lidhje me mosprezencën e konstatuar në datën 05.05.2021, nëpunësja ka sqaruar pranë Komisionerit se, për shkak të gjendjes shëndetësore nuk ka qenë prezente në vendin e punës vetëm në orën 08:15, pasi më tej ajo ka vazhduar normalisht punën. Për më tepër, prej saj është vënë në dispozicion shkresa nr. 406 prot., datë 05.05.2021, “Dërgim dosje për rikomisjonim për vitin 2021”, e nënshkruar prej saj si dhe administratorit të Njesisë Administrative Fierzë, nëpërmjet të cilës kërkon të provojë pretendimin e saj, se atë ditë ka qenë në punë dhe në asnjë moment nuk ka lënë detyrën pa kryer. Nëse do të ishte patur parasysh një fakt i tillë nga organi disiplinor, fakt i cili mund të evidentohet vetëm nëse do të ishte kryer rregullisht seanca dëgjimore, mund të kishte ndikuar në arritjen e një konkluzioni më të drejtë.

Ndërsa në lidhje me mosprezencën e konstatuar në datën 11.05.2021, nëpunësja, nëpërmjet ankesës së paraqitura pranë Komisionerit ka parashtruar se: “Për shkak të distancës prej 17 km nga vendi i punës me vendbanimin e saj (qyteti i Bajram Currit) dhe për shkak të situatës së krijuar nga COVID 19, ka pasur leje verbale prej Kryetarit të Bashkisë Tropojë dhe Administratorit të Njesisë Administrative, për t’u paraqitur në punë në orën 7:50 dhe për t’u larguar në orën 15:00, me qëllim shfrytëzimin e mjeteve të transportit të HEC”.

Në vijim të analizës së ligjshmërisë së procedimit disiplinor, konstatohet gjithashtu, se në urdhrin nr. 95, datë 21.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “*Për dhënien mase disiplinore*”, nuk janë të evidentuara qartësisht rrethanat dhe veprimet e kryera nga nëpunësja *****, të cilat përbëjnë thyerje të rregullave të etikës. Në lidhje me këtë shkelje të pretenduar në ngarkim të kësaj nëpunëseje, prej institucionit të Bashkisë Tropojë është dërguar shkresa nr. 1449/2 prot., datë 19.05.2021, e përpiluar prej nëpunësit *****, në cilësinë e anëtarit të grupit me detyrë kryerjen e verifikimit të prezencës në punë në datën 05.05.2021. Në përmbajtje të këtij akti, ky nëpunës ka deklaruar se: “*Pas njoftimit që ju është bërë punonjësve për shkeljen që kanë kryer dhe për heqjen e ditës së punës, punonjësja ***** më ka telefonuar, pasi jam pjesë e komisionit dhe më ka kërkënuar e ofenduar në orarin e punës, pasi sipas saj unë i kisha hequr ditë pune*”.

Duke vlerësuar dhe analizuar tërësinë e dokumentacionit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se organi disiplinor (*eprori direkt*), nuk ka kryer verifikim apo hetim të mjaftueshëm administrativ, por është mjaftuar duke marrë të mirëqëna ato fakte dhe arsyetime që janë ofruar prej anëtarëve të grupit të punës dhe pranuar se jemi para një shkelje disiplinore.

Në kushtet e pretendimeve të paraqitura prej nëpunësit *****, eprori direkt duhet të kishte zhvilluar seancë dëgjimore, ku të mundësohej jo vetëm ballafaqimi i qëndrimeve të të dyja palëve, por dhe e drejta e nëpunëses ***** për të parashtruar prova dhe argumente në lidhje me shkeljet e pretenduara në ngarkim të saj. Eprori direkt, në cilësinë e organit disiplinor duhet të kishte respektuar të gjitha etapat procedurale administrative, të përcaktuara në Kreun II, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”.

Së treti, rezulton se urdhri nr. 95, datë 21.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “*Për dhënien mase disiplinore*”, në ngarkim të nëpunëses *****, nuk është një akt administrativ sipas formës së kërkuar nga ligji, pasi në të evidentohen mangësi të elementëve të detyrueshëm të një akti administrativ.

Në ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, konkretisht në nenet 98-104, përcaktohen kërkesat formale që duhet të përmbush një akt administrativ, sipas së cilës, akti administrativ duhet të ketë formën e kërkuar nga ligji, duhet të jetë i arsyetuar, ku të pasqyrohen qartësisht shpjegimet e situatës faktike, shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave.

Procedimi disiplinor, referuar dispozitave që rregullojnë këtë aspekt të ligjit, finalizohet me vendimin përfundimtar të organit disiplinor, nëpërmjet të cilit mund të vendoset marrja e masës disiplinore osë ndërprerja e ecurisë disiplinore. Ky vendim, i cili përbën një akt administrativ, në kuptim të Kreun II, pika 19, të VKM nr. 115, datë 05.03.2014, duhet të

përmbajë të dhëna në lidhje me organin që ka marrë vendimin; identitetin e nëpunësit ndaj të cilit është marrë masa; masën e marrë; shkeljen faktike të kryer; bazën ligjore, arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve, që janë bërë shkak për marrjen e këtij vendimi, e të tjera.

Për sa është parashtruar edhe më sipër, rezulton se, në rastin e nëpunëses ***** , vendimmarrja e eprorit direkt nuk është në formën e kërkuar nga ligji, pasi jo vetëm që rezulton të jetë në formën e një urdhri dhe jo vendimi, por ai nuk është i arsyetuar dhe nuk ka një analizë të rrethanave dhe fakteve, të cilat kanë përbërë shkak për marrjen e masës disiplinore.

Nga analiza e gjithë sa u tha më sipër dhe në referencë të dispozitave të mësipërme ligjore të përmendura rast pas rasti, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se vendimmarrja e Kryetarit të Bashkisë Tropojë nuk është rezultat i një hetimi të plotë, të gjithëanshëm dhe të paanshëm administrativ, por me shkeljet e konstatuara gjatë këtij procesi administrativ, krijohet bindja se jemi para një vendimmarrjeje dhe një procesi i cili përmban në vetvehte elementë kundërligjshmërie, të cilat kanë patur ndikimin e tyre në arritjen e një përfundimi të drejtë.

Në këto kushte, arrihet në përfundimin se, urdhri nr. 95, datë 21.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, *“Për dhënien mase disiplinore”*, për nëpunësen ***** , është një akt administrativ, i cili në kuptim të nenit 109, gërmat b dhe c, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, përbën një akt të paligjshëm, i cili në referencë të neneve 113 pika 1 dhe 114, pika 1, të po këtij ligji, ky akt duhet të anulohet nga vetë organi që e ka nxjerrë. Pas kësaj nuk ka asnjë pengesë që çështja të rishqyrtohet, duke patur parasysh respektimin e legjislacionit të shërbimit civil, duke evituar gjithë shkeljet e përmendura në pjesën e mësipërme të këtij vendimi.

Në lidhje me pretendimin tjetër, se akti nr. 97, datë 17.04.2020, i Kryetarit të Bashkisë Tropojë, *“Për komandimin e nëpunëses civile *****”*, përbën një akt të paligjshëm me arsyetimin se gjatë transferimit nuk është ruajtur kategoria e pozicionit të punës, Komisioneri konstaton se transferimi është kryer brenda të njëjtit sektor dhe efektivisht kryen punë të të njëjtës natyrë, duke ruajtur kategorinë e pagës, vetëm se ka një kufizim të juridiksionit tokësor, nga territori i gjithë bashkisë, në territorin e një njësie administrative.

Pra, pretendimi nuk është i bazuar në thelbin e tij, por nga ana tjetër konstatohet që ky akt nuk është shprehur për kufizimin në kohë, deri në 6 muaj gjatë dy viteve, siç kërkon pika 1/a, e nenit 48, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, por është dhënë për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data 23.04.2020 deri në një urdhër të dytë.

Kjo parregullsi ka sjellë si pasojë që, megjithëse afati maksimal (6 muaj) i transferimit të përkohshëm ka përfunduar, nëpunësja vazhdon të mos jetë kthyer në pozicionin ku ka

emërimin e rregullt dhe për më tepër, me aktin administrativ të Kryetarit të Bashkisë Tropojë nr. 186, datë 28.07.2021, *“Për transferimin e përkohshëm të *****”*, ajo është komanduar/transferuar përsëri, në pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave”* në këtë bashki, duke krijuar një gjendje paligjshmërie e cila duhet të rregullohet sa më parë, nëpërmjet kthimit të saj në vendin e punës ku ka emërimin e rregullt.

Në aktet e mësipërme të transferimit të përkohshëm gjendet edhe një element tjetër parregullsie: ndryshe nga mënyra si është vepruar në rastin konkret, ku transferimi është kryer nga Kryetari i Bashkisë, në bazë të Kreut I, pika 4 dhe 5, vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, organi kompetent për kryerjen e transferimit të përkohshëm është njësi përgjegjëse, e cila vepron në bazë të kërkesës së drejtuesit të institucionit, drejtorisë përkatëse, etj. Megjithatë, kjo është një parregullsi formale e cila nuk ndikon drejtpërdrejt në vlefshmërinë e veprimeve administrative të kryera dhe vihet në dukje për ta patur parasysh që të mos përsëritet në të ardhmen.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në nenin 109, gërmat b dhe c, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Kryetari i Bashkisë Tropojë, bazuar në nenin 114, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, të anulohet urdhrin nr. 95, datë 21.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, *“Për dhënien mase disiplinore *****”*.
2. Në rast se çmohet e arsyeshme, të përsëritet procedura disiplinore duke respektuar të gjitha kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, siç edhe është përshkruar në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, në mënyrë që të arrihet në një përfundim sa më të drejtë e objektiv.
3. Kryetari i Bashkisë Tropojë, të vendosë anulimin e aktit administrativ nr. 186, datë 28.07.2021, *“Për transferimin e përkohshëm të *****”*, dhe bazuar në pikën 4, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar të urdhërojë kthimin e nëpunëses ***** në pozicionin e punës ku ajo ka emërimin e rregullt.

4. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Bashkinë Tropojë, duhet të tregojë kujdes në të ardhmen që në rastet e transferimit të përkohshëm të nëpunësve civilë, për nevoja të institucionit, të mbahen parasysh kërkesat e nenit 48, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të aktit nënligjor që rregullon këtë institut.
5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Të njoftohet për këtë vendim Kryetari i Bashkisë Tropojë, njësia përgjegjëse e institucionit dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha